



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jediti, Org. Unit	01	N. Prot. Br. Prot. Prot. No.	129
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	01	Data Datum Date	08.02.2024
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/129/2024
Datë: 08/02/2024

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në bazë të nenit 11, paragrafi 4, të Ligjit Nr.05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë dhe nenit 18 i Rregullores nr. 02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur më datë 08.02.2024 merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet procesverbali i takimit të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë i mbajtur më 26 dhjetor 2023;
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Vendimi i dërgohet:
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë

Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë





REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedra, Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. prot., Prot. No.	130
Nr. Fneeve Br. Stranica No. Pages	01	Data Datum Date	08.02.2024
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/130/2024
Datë: 08/02/2024

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në bazë të nenit 10, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenit 19, paragrafi 6 të Ligjit Nr.05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë dhe nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 i Rregullores nr. AD/02/2023 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur më datë 08.02.2024 merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Rregullorja Nr.1/2024 për Trajnimin Fillestar.
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues.

Vatën Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:
Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë
Udhëheqësit të Divizionit për Trajnim Fillestar
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë





REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE	
Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.
01	131
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	Data Datum Date
02	08.02.2024
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/131/2024
Datë: 08/02/2024

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në bazë të nenit 10, paragrafi 1, nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, nenit 13, paragrafi 1 i Rregullores 03/2017 për Trajnimin Fillestar, dhe nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11 i Rregullores nr. AD/02/2023 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur më datë 08.02.2024 merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi për zbatimin e programit/moduleve për prokuroren znj. Dena Arapi që nuk janë pjesë e programit të gjeneratës së X-të të prokurorëve, sipas shtojcës nr. 1.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:
Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë
Udhëheqësit të Divizionit në Programin Fillestar
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



Shtojca nr. 1

Me qëllim që prokurorja të kryej trajnimin fillestar me gjeneratën X të prokurorëve dhe t'i nënshtrohet testit përfundimtar, propozojmë që këto nën modulet t'i realizojë e vetme për 6 (gjashtë) ditë trajnimi, duke i zëvendësuar 6 (gjashtë) ditë në trajnimin praktik. Duke u bazuar se prokurorja do t'i ndjekë këto trajnime vetëm, ka mundësi që përmbajtja të trajtohet më shpejt, propozojmë që disa sesione të fuzionohen si në vijim:

1. Moduli KEDNJ – të realizohet në 2 ditë trajnimi (7 sesione trajnuese)
2. Kodi penal -pjesa e veçantë –1 ditë trajnimi (2 sesione)
3. Krimi kibernetikë – 1 ditë trajnimi (katër sesione)
4. Bashkëpunimi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar – 1 ditë trajnimi (2 sesione)
5. Shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesa pasurore juridike – 0.5 ditë trajnimi (1 sesion)
6. Përgjegjësia e personave juridik – 0.5 ditë trajnim (2 sesione)

Gjithsejtë: 6 (gjashtë) ditë trajnimi



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedin. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	132
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	01	Data Datum Date	08.02.2024
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/132/2024
Datë: 08/02/2024

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në bazë të nenit 10, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenit 19, paragrafi 6 të Ligjit Nr.05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë dhe nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 i Rregullores nr. AD/02/2023 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur më datë 08.02.2024 merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Rregullorja Nr.02/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.01/2023 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë.
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues.

Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:
Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Në bazë të nenit 10, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenit 19, paragrafi 6 të Ligjit Nr.05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë dhe nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 i Rregullores nr. AD/02/2023 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur më datë 08.02.2024 miraton këtë:

RREGULLORE
AD NR. 02/2024
PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR.01/2023 PËR
TRAJNUESIT DHE MENTORËT E AKADEMISË SË DREJTËSISË

NENI 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores Nr. 01/2023 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të zbatueshme për gjithë trajnuesit dhe mentorët që shërbejnë në Akademinë e Drejtësisë, si dhe për gjithë stafin e Akademisë së Drejtësisë

Neni 3

Nenit 9A të kësaj Rregullores 01/2023 për plotësim ndryshimin e Rregullores për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë i hiqet paragrafi 2 dhe plotësohet dhe ndryshohet si në vijim:

Neni 9A
Mënyra e angazhimit të Trajnuesve në Trajnime

1. Angazhimi i Trajnuesve në trajnime varet nga Programi Trajnues i miratuar nga Këshilli Drejtues.
2. Përfshirja në listën e trajnuesve të miratuar nga Këshilli Drejtues, nuk garanton me automatizëm edhe angazhim të trajnuesve në Trajnime.
3. Angazhimi i Trajnuesve varet nga:
 - 3.1 Objektiva specifike e Trajnimit;
 - 3.2 Ekspertiza përkatëse e trajnuesit;
 - 3.3 Vlerësimi i punës së trajnuesit;
 - 3.4 Në rastet kur dy apo më shumë trajnues në mënyrë të barabartë i plotësojnë kushtet e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, Akademia e Drejtësisë do të bëjë angazhimin e tyre në mënyrë racionale.

Neni 4

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë.

Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë



Prishtinë, 08.02.2024



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË ACADEMY OF JUSTICE			
Nr. Prot. Org. Jettë Org. Lëndë	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	133
Nr. Fajese Br. Stranica No. Pages	03	Data Datum Date	08.02.2024
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/133/2024
Datë: 08/02/2024

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 25, paragrafi 2, të Ligjit Nr.05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë dhe nenit 8 të Rregullores Nr. 01/2023 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.02/2019 për Trajnues dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur më datë 08.02.2024 merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e kompensimit për Trajnuesit e përkohshëm në Akademinë e Drejtësisë

- I. Trajnuesit e përkohshëm në Akademinë e Drejtësisë do të kompensohen sipas tarifave të përcaktuara për kompensimin e Trajnuesve **(shtojca nr. 1)**.
- II. Detyrat dhe përgjegjësitë e Trajnuesve të Përkohshëm të angazhuar në zbatimin e programeve trajnuese të AD-së, janë të përcaktuara me aktet normative dhe kontratë.
- III. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi nr. 01/493/2023, i dt. 19.10.2023
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:
Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë
Departamentit për Administratë dhe Financa
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë

Shtojca nr. 1

Tarifat për Kompensimin e Trajnuesve

Nr.	Aktiviteti i trajnuesit (sipas Nenit 4/3 të Rregullores)	Shuma/Programi	Udhëzimi
1.	Angazhimi i trajnuesve në Programin e Trajnimit Fillestar/PTF		
1.1	Ligjërimi, përgatitja, zhvillimi i prezantimeve vizuale, rastet praktike, raporti i trajnuesit ¹ (hartimi dhe vlerësimi i detyrës), hartimi i pyetje dhe përzgjedhja e rasteve praktike për provimin përfundimtar	40€ /ora	Për një sesion të PTF-së (3 orë) Gjithsej 120 €
1.2	Hartimi dhe zhvillimi i Modullit për trajnim	30 € për modul	PTF = Modul Trajnues
1.3	Përditësimi i Modullit për trajnim	15 € për modul	
1.4	Anëtari i panelit për vlerësimin e provimit përfundimtar	60 €	Shqyrtimi dhe plotësimi i listës përfundimtare të pyetjeve, përzgjedhja dhe plotësimi me raste nga praktika gjyqësore për provimin përfundimtar
1.5	Anëtari i Panelit për shqyrtimin e ankesave për rezultatet e provimit përfundimtar	60 €	Shqyrtimi i ankesave për rezultatet e provimit përfundimtare
1.6	Mentorimi i gjyqtarit/prokurorit të sapo emëruar të shtetit, gjatë zbatimit të trajnimit praktik	100 €	Sipas vendimit nr. 01/18/2016
2.	Angazhimi i trajnuesve në Programin e Trajnimeve të Vazhdueshme/PTV		
2.1	Ligjërimi, përgatitja dhe zhvillimi i prezantimeve vizuale, rasteve praktike, pyetësorëve para dhe pas aktivitetit trajnues duke përfshirë hartimin e raportit përmbledhës	20 €/ora	Për një ditë aktiviteti trajnues ² të realizuar në PTV (6 orë) Gjithsej 120 €
2.2	Zhvillimi i materialit për module dhe kurse të trajnimit	30 €	Përfshinë materialet e shtypur që do t'u ofrohen pjesëmarrësve në trajnim

¹ Raporti i trajnuesit përfshinë hartimin dhe vlerësimin e detyrës gjatë realizimit të trajnimit teorik

² Realizmi i aktivitetit trajnues apo tryezës së diskutimit nga dy bashkë trajnues

2.3	Përditësimi i materialit të zhvilluar për module dhe kurse të trajnimit	15 €	Materiali i përdorur në trajnim
2.4	Ligjërimi, moderimi dhe fasilitimi i paneleve të tryezave, konferencave dhe punëtorive për elaborimin dhe diskutim të çështjeve nga praktika gjyqësore	150 €	Përfshirë hartimin e materialit për moderimin dhe fasilitimin e çështjeve në diskutim në tryeze, konference apo punëtori, si dhe raporti përmbledhës me diskutime dhe konkluzione
2.5	Angazhimi në cilësinë e panelistit në tryezën për diskutim të çështjeve nga praktika gjyqësore	100 €	Përfshirë hartimin e materialit për diskutimin e çështjeve të praktikës gjyqësore si dhe për kontribut në hartimin e raportit përmbledhës me diskutime dhe konkluzione
3	Angazhimi i trajnuesve në Hartimin e programeve trajnuese		
3.1	Për angazhimin në hartimin e programeve trajnuese	100 € për ditë	Hartimi i koncepteve të trajnimit sipas fushave
4	Angazhimi në zhvillimin e veprimtarisë botuese të AD-së		
4.1	Anëtar i panelit redaktues të artikullit për revistën	60 €	Redaktimin e një artikulli i cili është i dedikuar për publikim në revistën e AD-së
4.2	Autori i punimit të artikullit për revistën	120 €	Punimi duhet të ketë min 15 faqe i faqeve
4.3	Autori i përmbledhjes, komentarit apo udhëzues të praktikës gjyqësore	120 €	Kompensimi bëhet me teme, min 15 faqe duke përfshirë tekstin e cituar
4.4	Autori i doracakut	120 €	Minimin 20 faqe kontribut në doracak
4.5	Bashkautorë, kontribues në hartimin e doracakut dhe formateve tjera të ngjashme	60 €	Minimin 10 faqe kontribut në doracak dhe forma të tjera të ngjashme

Ne Trajnimin e Vazhdueshëm 1 ditë = 6 orë; në Trajnimin Fillestar 1 ditë = 3 orë.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Niviu, Org. Org. Jedrit. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	134
Nr. Fazeve No. Stranica No. Pages	01	Data Datum Date	08.02.2024
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/134/2024
Datë: 08/02/2024

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në bazë të nenit 6, paragrafi 1.4, të Ligjit Nr.05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë dhe nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11 i Rregullores nr. AD/02/2023 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, më datë 08.02.2024 merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë dhe Odës së Ndërmjetësuesve sipas Memorandimit të Bashkëpunimit në mes të AD-së, MD-së dhe ONK-së me Nr. 01-195 i dt. 07.02.2024, për organizimin e trajnimeve rifreskuese për gjithë Ndërmjetësuesit e licencuar në Republikën e Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:
Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë
Ministrisë së Drejtësisë
Odës së Ndërmjetësuesve
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË ACADEMY OF JUSTICE			
Nr. Njësia. Org. Org. J. d. l. n. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	135
Nr. Vërejtje Br. Shënime No. Pages	01	Fata Datum Date	08.02.2024
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/135/2024
Datë: 08/02/2024

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në bazë të nenit 10, paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 dhe 1.9 të Ligjit Nr.05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë, më datë 08.02.2024 merr këtë:


V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vazhdimin e ofrimit të trajnimit teorik dhe testit përfundimtar për Gjyqtarët Porotë, të cilët nuk kanë arritur ta ndjekin trajnimin teorik gjatë vitit 2023.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:
Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë
Këshillit Gjyqësor të Kosovës
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë





REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia, Org. Org. Jedra. Org. Unit	01	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	138
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	02	Data Datum Date	12.02.2024
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/138/2024
Datë: 08/02/2024

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në bazë të nenit 10, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe nenit 11, paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-095, për Akademinë e Drejtësisë, më datë 08.02.2024 merr këtë:


V E N D I M

1. Miratohet propozimi për shkurtrimin e kohëzgjatjes së trajnimit bazik për bashkëpunëtorët profesional sipas shtojcës nr. 1.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Vaton Durguti

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:
Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë
Udhëheqësit të Divizionit për Trajnime të Vazhdueshme
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



Shtojca nr. 1

**Moduli Bazik Civile dhe Penale për Bashkëpunëtor Profesional dhe Zyrtar Ligjor
Struktura dhe Kohëzgjatja e trajnimeve**

PENALE dhe DREJTËSIA PËR TË MITUR				CIVILE			
Nr.	Materiale	Nr.	Procedurale	Nr.	Materiale	Nr.	Procedurale
1.	Zbatimi i Ligjit më të favorshëm, Shkaqet e Përrjashtimit të Kundërligjshmërisë, Pjesa e Posaçme e së Drejtës Penale si dhe Veprat Penale kundër integritetit Seksual 1 dite	1.	Fazat e procedurës penale 1 dite	1.	E drejta e trashëgimisë dhe e Drejta familjare 2 dite	1.	Procedura Kontestimore 3 dite
2.	Cilësia e kryerësve - kuptimi i personit zyrtar dhe Politika ndëshkimore për veprat penale te korrupsionit 1 dite	2.	Aktakuza, shqyrtimi gjyqësor dhe arsyetimi 1 dite	2.	E drejta e punës 1 dite	2.	Procedura përmbartimore 1 dite
3.	Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale si dhe veprat penale nga Kapitulli XXVI, Kapitulli XXIII, Kapitulli XXX dhe Kapitulli XXIX të KPK-se 1 dite	3.	Mjetet Juridike dhe Procedurat e veçanta 1 dite	3.	E drejta pronësore 2 dite	3.	Dhuna në familje 1 dite
4.	Parimet e procedurës ndaj të miturve dhe Masat dhe dënimet ndaj të miturve 1 dite			4.	E drejta e detyrimeve 1 dite	4.	Ndërmjetësimi 1 dite
4 dite trajnimi		3 dite trajnimi		6 dite trajnimi		6 dite trajnimi	
7 dite trajnimi / Propozim 5 ditë				12 dite trajnimi / Propozim 5 ditë			
19 ditë trajnimi/ Propozim 10 ditë							